



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUSHTRRI

01 Nr./ Br 174/16

Nr. i fq./ Br. st - 23 -

Data/ Datum 29. 09. 2016

VUSHTRRI - VUSHTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E VII-të E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 KORRIK 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fatime Haziri, Habibe Gërxfhaliu, Habib Mustafa, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Hysni Gërguri, Agron Përçuku dhe Fakete Dushi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, Nënkryetari i komunës përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike (KTV dhe Klan Kosova) dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i Kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – pasi hapi punimet e mbledhje se kuvendit, kërkoi që të mbahet një minutë heshtje për tragjedinë që ka ndodhur në Munchen të Gjermanisë ku ka gjetur vdekjen edhe një qytetar nga Komuna e Vushtrrisë (Dijamant Zabërgja). Tutje ai sqaroi se në materialin e kuvendit të paraparë në rend të ditës janë shtuar edhe dy pika shtesë të rendit të ditës të propozuara nga ana e kryetarit të komunës, dhe atë Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës (tokë bujqësore dhe kullosa), njoftimi lidhur me draft-buxhetin e komunës për vitin 2017, si dhe Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare nga fondi për subvencione për ndërtimin e shtëpive për Lutfi Hajdarin, dhe Naser Bilallin.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së - tha se pas rekomandimeve të marra nga ministria e linjës jemi të obliguar të sjellim para kuvendit propozim-vendimin për ndryshimin e vendimit të aprovuar në muajin qershor 2016 lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, dhe rekomandimet kanë të bëjnë me emërtimin e vendimit si vendim paraprak, çmimin fillestar dhe procedurat e ankandit konform Ligjit për dhënien e pronës në shfrytëzim.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP - kërkoi që të futen në rend dite dy pika shtesë, të cilat ishin shqyrtuar në mbledhjen e kaluar të kuvendit, ku njëra pikë ka të bëjë me ndërrimin e destinimit të pronës nga destinimi “Lumë” në rrugë publike, kurse pika tjetër është propozim-vendimi për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale nga Shtëpia Ndëshkuese Përmirësuese (Burgu i Smrekonicës).

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - Propozoi që gjatë pauzës të mbledhjes së kuvendit, anëtarët e kuvendit në mënyrë të organizuar të shkojnë në fshatin Ropicë për ta ngushëlluar familjen e Dijamant Zabërgjes. Pastaj ai paraqiti vërejtjet e tij lidhur me vonesat e dërgimit të materialit të mbledhjes së kuvendit, andaj lidhur me këtë çështje kërkoi që të respektohet Rregullorja e punës së kuvendit (të respektohet afati që 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes të dërgohet materiali).

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – kërkoi që pika e cila ka të bëjë me peticionin e banorëve që banojnë në rrugët: “Shotë Galica”, “Azem Bejta” dhe “Jeronim de Rada” të shqyrtohet si pikë e tretë e rendit të ditës.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - vlerësoi se pika e cila ka të bëjë me Propozim-vendimin për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës nga Shtëpia Ndëshkuese Përmirësuese, nuk duhet të futet në rend të ditës për këtë mbledhje të kuvendit pasi që kjo pikë nuk është analizuar mirë dhe komisioni i cili është formuar për këtë çështje ende nuk e ka përfunduar punën e tij dhe në këtë rast kemi mjaft çështje të hapura e të pasqaruara, andaj kjo çështje duhet t'i ofrohet kuvendit për shqyrtim në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme kur të definohen këto dilema.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, e mbajtur më 20.07.2016;
3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2016;
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017;
5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë);
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm lidhur me pasqyrat financiare për vitin 2015;
7. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt: prill, maj, qershor 2016;
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015/2016;
9. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës ligjore;
10. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës së informimit;
11. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e Kryetarit të Komunës për nënshkrimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit “Sheykh Zayed”;
13. Shqyrtimi i Peticionit të banorëve që banojnë në rrugët: “Shotë Galica”, “Azem Bejta” dhe “Jeronim de Rada”;
14. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim;
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës (tokë bujqësore dhe kullosa);
 - c). Shqyrtimi i njoftimit lidhur me Draft-buxhetin e komunës për vitin 2016;

- ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione (për ndërtimin e dy shtëpive);
- d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës në pronësi komunale nga “lumë” në rrugë publike.
- dh). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve për nder të 1 shtatorit “Ditës së dëshmorëve”.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, e mbajtur më 20.07.2016

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin nga e mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së e datës 20.07.2016.

3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2016

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë ku ceket se gjendja e sigurisë në gjashtëmujorin e parë të këtij viti në komunën tonë ka qenë stabile dhe e kënaqshme, dhe se veprimet dhe angazhimi i zyrtarëve policorë ka qenë i fokusuar kryesisht në parandalimin e krimit dhe në zbulimin e rasteve dhe në këtë drejtim kanë arritur sukses (Lidhur me këtë konstatim ajo vlerësoi se pajtohet pjesërisht). Pastaj ajo paraqiti vërejtje sa i përket angazhimit të zyrtarëve policorë në trafik pasi që në këtë drejtim duhet të ketë angazhim më të madh në rrugët e qytetit, duke u fokusuar në mbarëvajtjen e komunikacionit. Në këtë kontekst u shpreh se qytetarët kanë shumë ankesa sa i përket parkimit të automjeteve në trotuare dhe në vende joadekuate, por edhe në vendet ku me shenja të komunikacionit është i ndaluar parkimi dhe ndalja. Mandej ajo vlerësoi se zyrtarët policorë duhet të kenë një bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Inspektimeve pasi që në disa rrugë të ngushta parkohen automjetet dhe kështu pengohen këmbësorët. Lidhur me këtë ajo paraqiti shembull ku rruga tek komuna e deri tek marketi “Viva fresh” në të cilën ekziston shenja e komunikacionit vetëm për “ndalim” aty parkohen automjetet në mëngjes dhe aty qëndrojnë deri në mbrëmje. Mandej rruga në drejtim të çerdhës së fëmijëve në të dy anët e kësaj rruge parkohen automjetet dhe qytetarët nuk mund të kalojnë nëpër trotuar e sidomos prindërit me fëmijë të vegjël. Në fund tha se tek sheshi “Adem Jashari”, përkatësisht në hyrje të këtij sheshi parkohen automjete në ç’rast rrezikohen këmbësorët nga ngasësit e automjeteve, kurse në këtë lokacion policia nuk shihet se merr masa për largimin e këtyre automjeteve.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - shfaq shqetësimin e tij lidhur me përdorimin e substancave narkotike nga nxënësit e shkollave të mesme dhe shtoi se në lokalitetet përreth oborreve të shkollave sillen persona të pandërgjegjshëm, të cilët mund t’i keqpërdorin këta nxënës që janë në moshë të re. Lidhur me këtë çështje kërkoi nga ana e zyrtarëve policorë, por edhe nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit që ta rrisin bashkëpunimin në parandalimin e këtyre dukurive negative.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit - në adresimin e tij lidhur me raportin e gjendjes së sigurisë vlerësoi se është një “Pasqyrë e keqe” për komunën tonë që inkasantët e KEDSIT dalin në terren bashkë me zyrtarë të policisë. Pastaj ceku se nuk është gjë e mirë që zyrtarët e policisë bashkë me inkasantë të shkojnë në shtëpitë e konsumatorëve, andaj lidhur me këtë pyeti se

KEDSI a ka marrëveshje bashkëpunimi me policinë që zyrtarët policorë të asistojnë gjatë punës së inkasantëve të KEDSIT.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - tha se e përkrah informatën në fjalë edhe pse ajo nuk është e plotësuar ashtu si duhet. Tutje parashtrroi disa pyetje: Sa janë të angazhuar zyrtarët policorë lidhur me pengimin e dukurisë së lëmshës për faktin se edhe përkundër shumë kërkesave nga anëtarët e kuvendit, numri i personave të cilët po kërkojnë lëmshë vetëm sa po shtohet (s qaroi se këta persona duhet të ndihmohen në mënyrë institucionale), pastaj fëmijët të cilët merren me punë të rënda gjë kjo e cila është në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve. Këta fëmijë shtyhen nga ana e prindërve të tyre që të kryejnë punë të rënda, kurse lidhur me këtë çështje pyeti se në sa raste zyrtarët policorë kanë intervenuar në parandalimin e keqpërdorimit të këtyre fëmijëve? Në vazhdim ajo theksoi problemin me qentë endacakë, si dhe apeloj që të respektohen rregulloret komunale lidhur me orarin e punës së lokaleve (restoranteve) në të cilat gjatë kësaj kohe organizohen shumë dasma dhe ahengje dhe prishet qetësia publike. Mandej pyeti se çfarë veprimesh janë ndërmarrë lidhur me parandalimin e zjarreve, si dhe tërhoqi vëmendjen që zëri nga institucionet e kultit (xhamitë) të zvogëlohet pasi kjo po i pengon shumë qytetarë.

Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit - paraqiti shqetësimin e saj lidhur me shtimin e qenve endacakë, të cilët paraqesin rrezik për nxënësit e ciklit të ulët dhe për këtë kërkoi që përveç tek shkolla "Naim Frashri" edhe tek shkolla "Mustafë Venhari" të angazhohet një njësi policore që do të përkujdeset për sigurinë e nxënësve gjatë orëve të para të ditës.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - tha se informata e servuar nga zyrtarët policorë është mjaft e shkurtër dhe se shumë gjëra nuk janë përfshirë në të. Pastaj ceku se në fshatin Prelluzhë ekziston një nënstacion i policisë, i cili është i karakterit shumetnik, dhe vlerësoi se në këtë nënstacion për shkak të mungesës së kushteve ata policë nuk mund ta kryejnë punën e tyre ashtu siç duhet. Mandej ceku se ndërtimi i trotuarit nga rruga magjistrale deri tek hekurudha në fshatin Prelluzhë e ka ngushtuar tej mase rrugën e automjeteve dhe kështu është vështirësuar komunikacioni, dhe në këtë rrugë asnjëherë nuk janë parë policë të cilët e ndihmojnë zhvillimin e komunikacionit.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë u ndal në dy çështje, të cilat sipas tij janë të natyrës primare dhe ato janë: Parandalimi i fatkeqësive në komunikacion dhe për këtë kërkoi shtimin e pikave të policëve nëpër rrugët e qytetit jo vetëm nëpër rrugët kryesore por edhe në rrugët anësore. Pastaj ai apostrofoi një fenomen që ka vërejtur kur biçiklistët ngasin në rrugët me kahje të kundërt dhe kjo paraqet mjaft rrezik andaj kërkoi që për këtë çështje të shtohen masat e kontrollit. Mandej çështjen tjetër të cilën ai e etiketoi është përdorimi i substancave narkotike nëpër shkolla, por edhe në lokalitetet tjera dhe për këtë pyeti se a kemi përdorim të këtyre substancave psikotrope, a kenë të dhëna zyrtare për inicim të ndonjë rasti për përdorimin e këtyre substancave dhe nëse kemi raste të tilla atëherë sa është numri i tyre. Lidhur me këtë çështje ceku se kapacitetet e policisë janë të mangëta dhe apeloj për një bashkëpunim gjithëpërfshirës institucional për parandalimin e dukurisë së përdorimit të substancave narkotike. Në fund tha se gjatë muajve të verës kur kemi kthim të madh të mërgimtarëve është mirë që policia të shtojë numrin e pikave të kontrollit pasi që ngasjet e shpejta shpesh po kushtojnë me jetë të njerëzve.

Muhamed Alidema, komandant i Stacionit Policor në Vushtrri - paraqiti sqarime lidhur me raportin e gjendjes së sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2016, duke dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar Informatës për gjendjen e sigurisë, theksoi se çështja e qenve endacakë tashmë nuk është vetëm problem i komunës, por është shndërruar në problem për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë çështje ai vlerësoi se është shumë e nevojshme mbase e domosdoshme që për këtë problem të gjendet një zgjidhje adekuate. Pastaj shtoi se prej se është aprovuar ligji, komuna për të pestën herë ka shpallur tender për trajtimin e këtyre qenve endacakë, mirëpo fatkeqësisht akoma asnjë

kompani e specializuar për këtë çështje nuk është paraqitur për ta marrë përsipër trajtimin e këtyre qenve. Në këtë kontekst ai theksoi se është shumë e nevojshme që Qeveria e Kosovës të marrë iniciativë për ndryshimin e ligjit apo që përmes ndonjë donacioni të ndikojë në gjetjen e ndonjë zgjidhje adekuate për këtë problem. Mandej lidhur me rrugën në fshatin Prelluzhë njoftoi se komuna në bashkëfinancim me Ministrinë e Pushtetit Lokal është duke ndërtuar trotuarin në fshatin Prelluzhë, por në të njëjtën kohë është edhe një projekt për zgjerimin e rrugës, kurse deri në realizimin e këtij projekti do të ketë vështirësi në qarkullimin e automjeteve dhe për këtë është mirë që policia të asistojë në zhvillimin e komunikacionit. Lidhur me çështjen e parkimit të veturave ceku se pas aprovimit të Rregullores për Menaxhimin e Parkingjeve, komuna ka filluar që t'i jap në shfrytëzim disa lokacione për vendosjen e parkingjeve dhe me këtë besojmë që do të rregullohet problemi i parkimit të veturave.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa ka kërkuar që në këtë draft-rregullore të futen edhe zona tjera, për faktin se vetëm me gjashtë zona qyteti nuk është i përfshirë mirë, andaj në këtë rast mendon se në këtë formë do të bëhej klasifikimi i zonave si dhe do duhej të bëhet rregullimi i bazës tatimore nëpër zona e cila do të ndikonte në përmirësimin e rritjes së inkasimit të tatimit në pronë dhe rritjen e të hyrave komunale për komunën tonë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që në secilin subjekt politik të formohen komisione që do të punojnë në ndarjen dhe klasifikimin e zonave tatimore dhe që në muajin shtator kur do të votohet kjo rregullore të vijë propozimi më i mirë, i cili do të inkorporohet në rregulloren finale.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - ripërsëriti propozimin e tij që familjet e dëshmorëve dhe ato të veteranëve të luftës së UÇK-së të lirohen nga obligimi i pagesës së tatimit në pronë dhe kërkoi që ky propozim të inkorporohet në Draft-Rregulloren për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017. Këtë propozim e ai e arsyetoi me faktin se disa komuna të Republikës së Kosovës janë duke e zbatuar një propozim të tillë.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017.
2. Diskutimi publik fillon nga data 01 gusht 2016 dhe zgjatë deri më 31 gusht 2016.
3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencën në Komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF), dhe komisioni për hartimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017, që si hartues dhe propozues i aktit në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2016.

5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë)

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - pyeti se a ka planifikuar komuna mjete financiare për pagesën e këshillave të fshatrave pasi një obligim i tillë buron nga neni 5 i kësaj rregulloreje, ku thuhet se brenda afatit prej gjashtëmuajsh duhet të bëhet kompensimi i tyre. andaj nëse nuk kemi planifikuar mjete, atëherë të hiqet ky nen nga rregullorja në fjalë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - pasi i falënderoi kryetarët e këshillave të fshatrave për punën e tyre të deritashme, propozoi që afati prej gjashtë muajve kur do të kompensohen këta këshilla, të bëhet tre muaj dhe që pas këtij afati këtë këshilla t'i marrin kompensimin e tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - propozoi që në nenin 2.2.5 tek këshilli i fshatit Studime e Epërme ku thuhet se do t'i ketë 6 anëtarë në ç'rast përfshihet edhe fshati Skoçan me 1 anëtar dhe kjo në raport me këshillin e fshatit Kunovik, i cili do t'i ketë 4 anëtarë. lidhur me këtë vlerësoi se këto fshatra janë të barabarta sa i përket numrit të banorëve dhe për këtë propozoi që dy këta këshilla t'i kenë nga 6 anëtarë. Pastaj tek neni 4.4 i cili thotë që komisioni për organizimin e procesit të votimit duhet t'i ketë 5 anëtarë, ai propozoi që këtu të përcaktohet që komisioni do të mund të funksiononte me 3 ose 5 anëtarë, kurse lidhur me kompensimin e këshillave propozoi që kuvendi të nxjerrë një vendim ku do të përcaktohej kompensimi dhe në të njëjtën kohe kërkoi që këto mjete të planifikohen në buxhetin për vitin 2017.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 22 vota "për", tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm lidhur me pasqyrat financiare për vitin 2015

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se Raportit i Auditorit të Përgjithshëm lidhur me pasqyrat financiare për vitin 2015, paraqet një gjendje faktike me të gjitha elementet e saj pozitive dhe negative të menaxhimit të financave në përgjithësi në komunën tonë. Tutje shtoi se në raportin e auditorit të vitit 2014 ka pasur gjithsej 10 rekomandime ku 3 prej tyre janë zbatuar, 4 tjera janë adresuar, kurse 3 nuk janë adresuar ende. andaj lidhur me këtë shtrohet pyetja se ku është efekti i auditimit, me këtë shprehu nevojën që të nxirret plani për zbatimin e rekomandimeve. Në vitin 2015 shihet se auditori ka dhënë më shumë rekomandime, ka gjithsej 17, një pjesë prej tyre janë me rrezik me prioritet të lartë e që ka nevojë që menaxhmenti komunal me në krye kryetarin e komunës të ndërmarrin veprime të menjëhershme për mënjanimin, respektivisht zbatimin e këtyre rekomandimeve. Në këtë rrafsh prioritet mbetet çështja e regjistrimit të pasurive të komunës, pastaj pagesat të cilat bëhen pa filluar punët në vlerë prej 30,000.00 € që janë paguar në vitin 2015, kurse punët duhet të fillojnë në vitin 2016. Mandej një vërejtje tjetër e cila është evidentuar është që auditori i brendshëm të orientohet në auditimin e tij në segmentet që paraqesin rrezik më të madh në punët dhe aktivitetet e komunës sonë. Një çështje tjetër e cila është për t'u habitur është ajo e kualifikuar *si dobësi sistematike në prokurim* pasi që Drejtoria e Prokurimit duhet të zbatohet me përpikëri udhëzimin administrativ 1/2014 të lëshuar nga KRPP-ja. Pastaj rekomandimi 6 paraqet prioritet me rrezik të lartë ku bëhet fjalë për shkollat dhe objektet tjera që janë kontraktuar me operatorë të papërgjegjshëm e ku gjendja nuk është e mirë për shkak se nuk janë zbatuar sanksionet

(penalet) ndaj këtyre operatorëve. Tjetër çështje me peshë të veçantë është ajo se duhet të fillohet të analizohet puna lidhur me shkeljet ligjore që kanë ndodhur në rastin e projektit për riciklimin e mbeturinave si në çështjet e tenderimit ashtu edhe punët tjera. Mandej ajo që po na përsëritet që disa herë që në rastet kur bashkëfinancimi është 50 me 50, atëherë komuna duhet të marrë përsipër zhvillimin e procedurave të prokurimit, e që në raport janë evidentuar disa vërejtje tek kontraktimi i punëve tek disa monumente historike siç janë ura e gurit dhe kalaja. Një dukuri tjetër që është me rëndësi të ceket është dështimi i sektorit të tatimit në pronën e paluajtshme, në identifikimin e pronave ku sipas raportit kemi 21.187 prona, kurse çdo vit kalendarik duhet të bëhet verifikimi i 1/3 së këtyre pronave se a kemi përputhje me shumat e caktuara me pronat e verifikuara, kur dihet fakti se gjatë këtij viti janë bërë vetëm 963 verifikime prandaj në këtë segment shihet se kemi një ngecje për faktin se të hyrat nga tatimi në pronë janë të hyra permanente.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se kur bëhet fjalë për raportin e auditimit të pasqyrave financiare të komunës për vitin 2015, atëherë duhet konstatuar se shumica e të thënave në raport janë përsëritur nga viti paraprak. Tutje ajo theksoi se edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa kishe deklaruar se në vitin 2014 Auditori i përgjithshëm në raport kishe parashtruar gjithsej 10 rekomandime nga të cilat 3 janë implementuar, të adresuara por jo të implemtuara 4, kurse të paadresuara fare kanë qenë 3 rekomandime. Nga kjo mund të nënkuptojmë se nga autoritetet komunale kemi pasur një neglizhencë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm. Në raportin e auditorit të përgjithshëm të vitit 2015 janë adresuar gjithsej 12 rekomandime, të cilat nëse analizohen me kujdes paraqesin rrezik për komunën tonë siç është p.sh punët kontraktuese të komunës me operatorë ekonomik të papërgjegjshëm, punë të cilat komunës me siguri se do t'i shkaktojnë dëme. Pastaj, dobësitë në verifikimin e pronave janë evidentuar gjithashtu në raport ku thuhet se 300 prona komuna jonë i ka të paverifikuara dhe si pasojë e kësaj komuna jonë do të humb shumë të hyra financiare. Mandej janë paraqitur shumë defekte në parashtrimin e shifrave që krijojnë hapësirë për dyshimet e caktuara. Pagesat e regjistruara disa herë, si dhe dobësitë sistematike në prokurim gjithashtu janë paraqitur si vërejtje në raportin e auditorit. Në fund kërkoi nga kryetari i komunës që të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e parashtruara nga auditori i përgjithshëm të merren seriozisht dhe të implementohen me qëllim që gjerat e tilla mos të përsëritën në të ardhmen.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar Raportit të auditorit për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2015, ceku se auditori ka parashtruar disa rekomandime, të cilat duhet sqaruar se rekomandimet e tilla nuk përkojnë me realitetin. Pastaj ceku se raporti është i kualifikuar mirë dhe se kishe kërkuar nga qeveria komunale që kur është ofruar drafti i këtij raporti të paraqiten vërejtjet dhe kundërshtimet lidhur me disa vlerësime që janë dhënë në këtë raport. Lidhur me konstatimet në raport për siç thuhet dobësitë sistematike në prokurim dhe të cilat i cilëson si prioritet i lartë i rrezikut, vlerësoi se në të vërtetë këto konstatime nuk përkojnë me realitetin. Lidhur me këtë konstatime ai në mënyrë ilustrative paraqiti shembullin kur një operator ekonomik gjatë dorëzimit të një oferte serioze në dosjen e dokumentacionit ka ofruar kopjen e vërtetimit të kryerjes së obligimeve të tatimit në pronë (dhe këtë auditori e ka cilësuar si prioritet i rrezikut të lartë), kurse kjo nuk mund të vlerësohet si rrezik i lartë për arsye se një fakt i tillë gjatë procesit të auditimit ka mundur të vërtetohet. Pastaj në faqen 20 të raportit çështja 7- Dobësitë josistematike – Prioritet i lartë ku thuhet se: Në projektin “Ndërtimi i shkollave fillore: Druar, Pantinë dhe Maxhunaj” komuna kishte lidhur kontratë në vlerë prej 867,757 edhe pse buxheti i parashikuar për këtë projekt për tri vite ishte 800,000 €. Pra komuna në këtë rast kishte në obligime më shumë sesa ndarjet e parashikuara buxhetore për 67,757€. Lidhur me këtë ceku se në raport janë disa konstatime, të cilat e prishin imazhin e punës së kryer nga Komuna e Vushtrrisë e që në të vërtetë përsërit se nuk përkojnë me realitetin.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me Raportin e auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2015, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se pa auditim të jashtëm të punës së pushteteve lokale nuk do të kishte kuptim dhe kualitet të punëve tona dhe në të njëjtën kohë nuk do kishte menaxhim të mirë të parasë publike në shkallën e një njëkoqiri të mirë. Tutje shtoi se gjatë punës mund të ketë edhe gabime, por ajo që është më e rëndë në kuptimin e përgjegjësisë është kur kemi pasoja materiale¹ të cilat mund të përcillen me konsekuenca ligjore për ndonjë zyrtar komunal. Pastaj ai vlerësoi se ajo çka është pozitive e cekur në raport është opinioni i dhënë si i pamodifikuar² që nënkupton se komuna është vlerësuar pozitivisht sa i përket pasqyrave financiare, por natyrisht se me theksim të çështjes që këto çështje janë ato të cilat janë përfshirë tek rekomandimet. Lidhur me çështjen e rekomandimeve të parashtruara nga auditori i përgjithshëm, komuna ka hartuar planin e veprimit për t'i adresuar këto rekomandime dhe për të mënjanuar defektet e identifikuar. Në vazhdim ai njoftoi se plani i veprimit ka paraparë mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm dhe ky plan do të ofrohet para anëtarëve të kuvendit gjatë këtij viti. Në kontekst të vlerësimeve të bëra në raport ai paraqiti disa sqarime para anëtarëve të kuvendit, më konkret në faqen 22 të raportit ku thuhet se komuna i ka depozituar 30,000€ në llogarinë e Lux Development për renovimin e infrastrukturës së ujërave të pijshme dhe për këtë sqaroi se komuna jonë ka një marrëveshje me Lux Development për financimin e disa projekteve nga ana e Luksemburgut. Në bazë të marrëveshjes së sipërcekur kompania Lux Development do të financojë projekte në vlerë prej 460,000 €, kurse komuna 300,000 €. Në kuadër të asaj marrëveshjeje komuna për vitin e kaluar ka pasur obligim të paguajë 30,000 €, kurse për këtë vit janë planifikuar 270,000 €. Pastaj ai njoftoi se marrëveshja e lartëshënuar është miratuar në kuvendin e komunës, ku në këtë marrëveshje parashihet që mjetet financiare të derdhen në llogarinë e kompanisë Lux Development dhe kjo ka ndodhur dhe se kjo në realitet nuk është në përputhje me ligjet pozitive të Kosovës. Pastaj njoftoi se Republika e Kosovës ka lidhur një marrëveshje me Qeverinë e Luksemburgut, marrëveshje e cila është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por e cila është zgjatë tej mase në afatin kohor dhe kjo ka paraqitur problem edhe për komunën tonë në zhvillimin e projekteve me kompaninë Lux Development. Lidhur me çështjen e depozitimit të mjeteve financiare në vlerë prej 30.000 € tha se ka bërë kërkesë që këto mjete të kthehen në llogarinë e komunës dhe për këtë temë do të mbahet një takim mes kompanisë Lux Development, auditorit dhe komunës sonë. Mandej lidhur me një gabim teknik në shifrën 8 milionë është intervenuar dhe ky gabim është përmirësuar. Në fund tha të gjitha rekomandimet e parashtruara nga ana e auditorit janë të mirëseardhura dhe do të merren për bazë më qëllim që në të ardhmen të mos na përsëriten situata të ngjashme.

7. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt: prill, maj, qershor 2016

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se raporti për të hyrat buxhetore ka paraqitur shumë të dhëna por jo edhe disa karakteristika, të cilat e karakterizojnë këtë periudhë raportuese. Ajo çka ai e vlerësoi si mjaft me peshë është një mobilizim gjithëpërfshirës për rritjen e të hyrave komunale, sepse realizimi i të hyrave në masën prej 74% mund të konsiderohet një ngecje në realizimin e planit të përgjithshëm, por kjo ndikon negativisht edhe në realizimin e projekteve. Sa i përket shpenzimeve mund të thuhet se në disa kategori kemi kursime. Kurse në disa tjera shpenzimet janë rritur si p.sh rritje kemi pasur në shpenzimet e rrymës nga 50,497.45 € sa kemi pasur vitin e kaluar këtë vit kemi 90,726.36 €, pastaj rritje kemi edhe në shpenzimet e telefonisë nga 2,560.13 € këtë vit kemi rritje në vlerë prej 4,000.18 €, pastaj rritje të shpenzimeve kemi edhe në kategorinë "Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka

¹ Shkaktim i dëmeve materiale për shkak të gabimeve, të cilat ndikojnë në dëmtimin e buxhetit të komunës.

² Auditori jep opinion të pamodifikuar nëse arrin në përfundim se pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

zyrtare)” nga 11,345.51 € sa ishin në vitin 2015 në vitin 2016 shpenzimet janë rritur në 16,381.61 €. Në fund tha se duhet të kemi racionalizim të shpenzimeve publike dhe mobilizim të kapaciteteve për ngritjen e inkasimit të të hyrave.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - kur bëhet fjalë për raportin për të hyrat dhe shpenzimet komunale, atëherë duhet konstatuar se të përskrimi i mallrave dhe shërbimeve duhet të bëhet specifikimi në mënyrë më të qartë. Mandej tek infrastruktura publike duhet të bëhet specifikimi i projekteve si p.sh pozicioni “Ndërtimi i trotuareve” (duhet të përcaktohet se cilat rrugë do të rregullohen me trotuar), pastaj rrugët e rendit të IV-të, cilat rrugë dhe në cilat lokalitete janë ndërtuar këto rrugë, ndërtimi i kanalizimeve dhe i parqeve për cilat projekte bëhet fjalë. Gjithashtu pyeti se cilat rrugë janë rregulluar me kubëza betoni, si dhe cilat do të rregullohen në të ardhmen. Në fund kërkoi që projektet kapitale para se të procedohen në kuvend të vijjnë të specifikuar, me qëllim që anëtarët e kuvendit të jenë në dijeni se për cilat projektet votojnë.

Abit Abiti , ZKF - paraqiti sqarime profesionale lidhur me raportin për të hyrat dhe shpenzimet komunale, duke dhënë përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015/2016

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - tha se informata në fjalë është gjithëpërfshirëse megjithatë ajo paraqiti disa vërejtje dhe sugjerime. Në faqen 3 të informatës ku janë përshkruar sfidat vlerësoi se është dashur të përmenden edhe kushtet e vështira në cilën punon shkolla e muzikës. Pastaj ceku se është mirë që shkolla fillore “Mustafë Venahari” është binjakëzuar me një shkollë nga Turqia dhe inkurajoi që Drejtorja e Arsimit dhe drejtoritë e shkollave të bëjnë përpjekje që të kemi edhe binjakëzime me shkollat e shteteve tjera. Lidhur me testin e arritshmërisë dhe testit të maturës që të dyja kanë rritje, si dhe shprehu shqetësimin e saj për orientimin e nxënësve në shkollat e mesme dhe për këtë DKA-ja duhet të angazhohet më shumë në çështjen e orientimit profesional të nxënësve me qëllim që të kemi një shpërndarje të barabartë në të gjitha shkollat e qytetit. Mandej ajo i uroi nxënësit të cilët kanë fituar në garat e diturisë në nivel të republikës. Në këtë drejtim ajo apeloi që jo vetëm Arbër Igrishta, por edhe nxënës tjerë (talentë) si p.sh Adrian Krasniqi të ndihmohen pasi që është një nxënës shumë i talentuar. Në këtë kontekst ajo tregoi përvojat nga shtetet tjera ku me nxënës të talentuar punojnë ekipe të posaçme profesionale për ngritjen e tyre. Në kuptimin e stimulimit të nxënësve tha se komuna duhet t’i shpërblejë nxënësit e dalluar dhe në këtë mënyrë do të nxiteshin edhe nxënësit tjerë për të arritur rezultate në mësim. Lidhur me trajnimin e stafit mësimdhënës duhet që në informatë të futen emrat e atyre mësimdhënësve që kanë ndjekur trajnimet (në rastin konkret kërkoi që në informatë të përfshihen emrat e 14 mësimdhënësve që kanë ndjekur trajnimet për menaxhim dhe udhëheqje të organizuara nga Gizi).

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit - tha se informata nga Drejtorja e Arsimit është një informatë e hartuar në mënyrë profesionale ku janë përfshirë shumë të dhëna. Por, megjithatë ajo paraqiti disa vërejtje tek tabelat e suksesit të nxënësve ku ceku se mungojnë kolonat në tabelat të klasave nga klasa e I-V, nga VI-IX, si dhe nga klasa X-XII (në këto tabela është dashur të paraqitet sukcesi i nxënësve pozitiv, përqindja, si dhe notat negative, numri i nxënësve dhe përqindja). Tutje shtoi se në afërsi të shkollës “Mustafë Venhari” është vërejtur mungesa e kapakëve të pusetave dhe nga kjo nxënësit janë të rrezikuar andaj në këtë rast kërkoi nga DSHP-ja që të bëhet vendosja e këtyre kapakëve të pusetave. Pastaj numri i mungesave të nxënësve nuk është i ndarë sipas shkollave sidomos në shkollat e mesme nuk është i ndarë numri i mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se informata është gjithëpërfshirëse dhe ceku se është shqetësues fakti i rënies së suksesit nëpër cikle shkollore. Niveli i parë që përfshin klasat nga I-V, sukcesi është i kënaqshëm, kurse niveli nga klasa VI-IX sukcesi vjen duke rënë, ndërkaq në shkollat e mesme sukcesi vjen duke rënë akoma më shumë. Në këtë kontekst vlerësoi se fëmijët tanë duke u rritur mësojnë më pak dhe bëjnë mungesa më shumë. Pastaj

ceku se informatata nuk e ndryshon gjendjen faktike dhe apeloj që të kemi një angazhim gjithëpërfshirës për ngritjen e nivelit të mësimin për nxënësit tanë dhe uljen e numrit të mungesave të paarsyeshme. Lidhur me garat e nxënësve shprehu kënaqësinë e saj për pjesëmarrjen e tyre dhe apostrofoi se në informatë mungojnë disa të dhëna lidhur me “bashkëpunime”, duke u nisur nga shkolla SHMU -2-, në ç’rast ka pasur pjesëmarrje edhe në gara tjera e që në informatë nuk janë cekur. Në vazhdim ajo e përshëndeti bashkëpunimin mes Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Kulturës lidhur me garat e recituesve dhe shprehu kureshtjen të dijë se kush ka qenë fitues i vendit të parë, vendit të dytë dhe vendit të tretë në këto gara dhe që këta emra të përfshihen në informatë. Pastaj vlerësoi se në informatë duhet të përfshihet edhe bashkëpunimi mes Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë, ku është realizuar kontrolli sistematik i nxënësve në shumicën e shkollave të komunës. Në fund tha se duhet të kemi një angazhim të përgjithshëm për mbështetjen e nxënësve të dalluar.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - tha se nxënësit me aftësi të kufizuara, të cilët janë të përfshirë në klasë të rregullta, me qëllim të përshtatjes së tyre nëpër këto klasë nevojitet që me këta nxënës në mënyrë individuale të punojë psikologu apo pedagogu. Lidhur me këtë çështje ajo i sugjeroi DKA-së që mësimdhënësit që merren me këta nxënës, të kryejnë trajnime me qëllim të arrijtes së rezultateve sa më të mira me këta nxënës.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë ceku së janë realizuar vizita sistematike shëndetësore në shkollat e qytetit dhe njoftoi së në këtë vit ka qenë një risi sepse të gjithë nxënësve iu është bërë analiza e ujit. Tha se një fenomen që i ka rënë në sy te nyjet sanitare nëpër shkolla është se nuk janë higjienike dhe atë e shqetëson fakti se në ato vende ku njejt sanitare janë me guaska infeksionet e traktit urinar gjatë analizave gjithmonë kanë dal keq. Një çështje tjetër që e shqetëson atë është se edhe nëpër shkolla tjera ka mungesë të ujit edhe kanalizimet nuk janë adekuate. Ai kërkoi që gjatë renovimit të shkollave dhe gjatë renovimit të njejtve sanitare të ketë një monitorim nga organet kompetente më të mirë të kryesve të punëve. Dhe sa i përket kanalizimit nëpër shumë shkolla nuk kanë qenë adekuate, nuk e di a ka qenë për shkak të mungesës së ujit apo për shkaqe të tjera, por ka pasur shumë erëra. Ai po ashtu u pajtua me mendimin që Drejtoria e Arsimit të punësojë një psikolog nëpër shkolla sepse ka një numër të madh të nxënësve që janë në mungesë zhvillimi psiko-fizik. Në fund tha së psikologu në shkollë do të ishte shumë i nevojshëm në identifikimin e problemeve të ngecjes në zhvillim të nxënësve (kemi nxënës që vuajnë nga sindromi i autizmit).

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – kërkoi nga kuvendi që të futet për shqyrtim kërkesa e Shoqatës së Dëshmorëve, Dega në Vushtrri për ofrimin e ndihmës financiare për organizmin e aktiviteteve për nder të 1 shtatorit “Ditës së Dëshmorëve”. Këtë pikë e arsyetoi me faktin se muaji gusht është koha kur kuvendi gjendet në pushim dhe këto mjete nuk do të mund të ndahen në kohën e duhur për organizimin e kësaj date.

Pas votimit të këtij propozimi me 18 vota “për”, 1 votë “kundër”, të tjerat abstenim, futet në rend të ditës në pikën në të ndryshme, Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve për nder të 1 shtatorit “Ditës së Dëshmorëve”.

9.Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës ligjore

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se informatata e ofruar nga Zyra ligjore nuk është sa duhet e qartë e cila është e përshkruar me tepër me numra. Tutje ajo pyeti se në çfarë faze gjendet kontesti juridiko-civil ku palë ndërgjyqëse është operatori ekonomik, i cili ka ndërtuar rrugën Sllatinë-Tërllobuq e cila rrugë është dëmtuar brenda vitit garantues dhe e cila është në gjendje të shkatërruar edhe sot.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se kjo informatë e cila është ofruar nga Zyra ligjore është mjaft e shkurtër edhe përkundrejt faktit që është i kuptueshëm fakti që duhet të ruhet

konfidencialiteti i të dhënave të ndjeshme. Tutje duke u ndalur në numrin e aktiviteteve (seancave gjyqësore) ku ka përfaqësuar përfaqësuesi i komunës, pyeti se si rezultat i kujt ka ardhur deri tek paditë kundër komunës, se këto padi a janë bërë vetëm sa për të përfituar operatorët e ndryshëm ekonomik, apo janë padi si pasojë e mospërmbushjes së obligimeve dhe përgjegjësive nga sektorë të caktuar komunal. Pastaj ai vlerësoi se raportimi në këtë formë nuk parqet ndonjë gjë esenciale. Në fund tha se duhet të identifikohet se cilët resorë komunal bëjnë shkelje ligjore për shkak të mospërgjegjësisë së tyre.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor - paraqiti sqarime profesionale lidhur me informatën në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, ku ceku se informata është e standardit të njëjtët me herën e kaluar dhe atëherë nuk ka pasur vërejtje kurse tani po. Në fund njoftoi se për pyetjet e anëtarëve të kuvendit do ofrohen përgjigje me shkrim konform kërkesave të tyre në mbledhjen e ardhshme të kuvendit.

10. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës së informimit

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se roli i Zyrës së informimit duhet të intensifikohet edhe më shumë në mënyrë që komunikimi në mes të institucioneve komunale dhe qytetarëve të jetë edhe më i fuqishëm e që në këtë formë do të rritej intensiteti i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Përveç kësaj, përmes Zyrës së informimit është rritur transparencja e punës së kuvendit dhe puna e qeverisë komunale. Në këtë kontekst ajo vlerësoi se është mirë që tani është bërë pjesë e menaxhimit të informimit sepse, raportimet e ndara që i kemi pasur deri vonë shpeshherë nuk kanë dalë të plota. Tani, raportimet janë më të sakta, janë më të plota, më të shpejta dhe janë në kohë dhe mbi të gjitha janë gjithëpërfshirëse në të gjitha fushat e menaxhimit të performancës të komunës dhe të kuvendit. Andaj e gjithë kjo ka ndikuar që gjatë rishikimit të këtij sistemi nga MAPL-ja dhe mbështetur nga DEMOS, ka bërë që Komuna e Vushtrrisë të zgjidhet njëra ndër pesë komunat për pilotimin e këtij sistemi. Ky pilotim do të ndikojë në krijimin e një metodologjie unike të raportimeve nga të gjitha komunat e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe transparencën si fushë e rëndësishme shoqërore. Përveç tjerash tek informatat që i marrim nga Zyra e informimit, sigurisht që anëtarëve të kuvendit iu "ka ra në sy" sintagma "Ju lutem kenë parasysh mjedisin para se të shtypni këtë e-mail". Kjo në një formë apo në një tjetër ndikon në ruajtjen dhe kujdesin ndaj ambientit.

11. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e Kryetarit të komunës për nënshkrimin e "Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit "Sheykh Zayed"

Adnan Klinaku, anëtar i kuvendit - lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit "Sheykh Zayed" propozoi që tek pika 1.5 obligimet e palëve dhe 2.5 ku kemi të bëjmë me transportin e pacientëve në qendrën terciare, propozoi që stafi i mesëm të mos angazhohet nga shërbimi emergjent, por të angazhohet nga reparti gjegjës ku është pacienti për shkak të natyrës së rasteve dhe përgatitjes profesionale. Tutje shtoi se duhet të rritet numri i mjekëve prej orës 19:00-24:00 gjatë sezonit verorë për shkak të rritjes së numrit të pacientëve dhe rritjes së patologjive të ndryshme meqë më këtë do të mundësohet trajnimi më i mirë dhe gabimet mjekësore do të ishin më të vogla. Mandej propozoi që bëhet funksionalizimi i laboratorit për 24 h konform parametrave që shihen në shërbimin emergjent e në këtë rast gjenden 2 apo 3 parametra, të cilët nuk kushtojnë shumë dhe me këtë do të bëhet një zgjidhje më e mirë për pacientët që mos të "bredhin nëpër qendrat tjera mjekësore".

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se parimisht e mbështet këtë marrëveshje dhe kërkoi që në një nen të caktuar të futet edhe modaliteti për njoftimin e kuvendit për këtë marrëveshje. Gjithashtu nga hartuesi kërkoi sqarime lidhur me nenin 4 të kësaj marrëveshjeje ku thuhet se : në rast kontesti palët, mosmarrëveshjet do t'i zgjidhin me bisedime dhe konsultime ndërmjet tyre.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se lidhja e kësaj marrëveshjeje është bërë për shkak të mungesës së kuadrit dhe kjo po bëhet për mundësimin e ofrimit të shërbimeve cilësore sekondare qytetarëve dhe me këtë kemi qenë të obliguar që stafin e emergjencës ta dërgojnë në të njëjtin objekt ku punon emergjenca e spitalit. Tutje shtoi se kishte me qenë mirë që Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave të lejojnë rritjen e numrit të stafit profesional ku do të ndaheshin shërbimet primare prej atyre sekondare, andaj si rezultat i mungesës së stafit është dashtë të lidhet kjo marrëveshje. Mandej vlerësoi se rastet, të cilat dërgohen nga shërbimi sekondar në shërbimin terciar, kishte me qenë mirë që për raste gjinekologjike me qenë mamia, për raste pediatrike me qenë motra e pediatrikë. Në fund tha se ky memorandum duhet të vazhdojë të jetë në fuqi derisa ministria ndan mjete financiare për pagesën e stafit shtesë profesional.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar një emisioni televiziv ku kishte referuar ministri i shëndetësisë ceku se i vjen keq që Ministria e Shëndetësisë dhe konkretisht ministri i kësaj ministrie nuk shprehu gatishmëri për ta ndihmuar Spitalin e Vushtrrisë sidomos në ndarjen e mjeteve për rritjen e numrit të punëtorëve profesional (stafit shëndetësor). Në këtë kontekst ai vlerësoi se kjo mosgatishmëri e ministrit tregon se ai nuk është i interesuar të përkrah shëndetësinë e komunës sonë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim autorizohet Kryetari i komunës për nënshkrimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit “Sheykh Zayde” në Vushtrri.

2.Qëllimi i kësaj marrëveshjeje mes Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit “Sheykh Zayde” është funksionalizimi i shërbimit urgjent dhe emergjent në Spitalin “Sheykh Zayde” në bashkëpunim me Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH).

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

13.Shqyrtimi i Peticionit të banorëve që banojnë në rrugët: “Shotë Galica”, “Azem Bejta” dhe “Jeronim de Rada”

Kadri Karaça, përfaqësues i banorëve parashtrues të peticionit - tha se kontesti lidhur me ndërtimin e xhamisë është i papranueshëm dhe shtoi se komuniteti që banon në këtë lokalitet nuk është kundër fesë dhe xhamisë, por është kundër vendit ku po ndërtohet kjo xhami, për faktin se ky lokalitet nuk i plotëson kushtet për t'u ndërtuar xhamia, si dhe në atë lokalitet ekziston xhamia në afërsi prej 100 metrave prej vendit ku është planifikuar të ndërtohet kjo xhami. Në vazhdim ai vlerësoi se do të ishte shumë më mirë që në udhëkryqin mes rrugëve “Shotë Galica”, “Azem Bejta” dhe “Jeronim de Rada” të ndërtohet një rrethrotullim, i cili do ta lehtësojë qarkullimin e komunikacionit si për këmbësorë ashtu edhe për automjete. Në fund tha se në lokalitetin ku po pretendohet ndërtimi i xhamisë më mirë kishte me qenë të ndërtohet ndonjë ambulancë apo ndonjë çerdhe, ku peronat e moshuar dhe fëmijët nuk do të prisnin për ta kaluar rrugën magjistrale, ku edhe i ekspozohen rrezikut.

Shemsi Rrahimi, kryetar KBI - dega në Vushtrri - njoftoi kuvendin se KBI-ja, dega në Vushtrri ka blerë një parcelë ku në saje të një donacioni nga EBA-ja ka planifikuar ndërtimin e një xhamie dhe për këtë ka lidhur një marrëveshje me komunitetin lokal tek noteri. Pastaj ceku se ndërtimi i xhamisë në atë pronë (parcelë) do të bëhet konform rregullave dhe standardeve ndërtimore që burojnë nga ligji dhe aktet tjera juridike, kurse për këtë kanë marrë pëlqimin nga ujësjellësi dhe KEDS-i dhe do t'i respektojnë rregullat e ligjit. Në fund tha se në atë lokalitet ka nevojë që të ndërtohet xhami dhe se prapa këtij projekti është gjithçka transparente dhe e sinqertë se nuk bëhet fjalë për grupe radikale fetare dhe apeloj tek anëtarët e kuvendit që t'i japin rekomandimin Drejtorisë së Urbanizmit për dhënien e lejes për ndërtimin e kësaj xhamie.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - tha se kuvendi i komunës nuk duhet të vihet në këso situata "para aktit të kryer" sepse sipas tij ky peticion nuk është dashur fare të vihet para kuvendit, as sot dhe asnjëherë, pasi që ky peticion është i manipuluar dhe i falsifikuar (ku dy persona i kanë vënë nënshkrimet për të gjithë personat tjerë që figurojnë në këtë peticion) pastaj, apeloj që në këtë çështje të peticionit të kyçet prokuroria për t'i hetuar këta persona. Në fund kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që çështje të tilla manipulative mos të sillen para kuvendit që anëtarët e kuvendit të sillen në këso lloj situatash të pakëndshme.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - duke iu referuar peticionit të këtyre banorëve për ndërtimin e xhamisë vlerësoi se këtë çështje e merr si të mirëqenë dhe si një çështje që qytetarët kanë të drejtë të bëjnë kërkesa dhe kundërshtime të caktuara për çështje që lidhen me interesat e tyre si komunitet. Por, është një çështje tjetër po aq me peshë që dëshiron ta deklarojë pa hezitim se mbi 90 % të komunitetit jemi të besimit (fesë) islam-e, dhe një çështje e tillë duhet të diskutohet me përgjegjësi dhe duhet të jemi të matur në kualifikimet që mund t'i kemi si rezultat i problemeve dhe paragjytimeve. Tutje duke iu referuar shkrimeve në portale elektronike, ku ngrihen dyshime lidhur me këto donacione e që për mendimin e saj janë të rënda vlerësimet e tilla për faktin se që disa vite EBA, ndihmojnë qytetarët e Vushtrrisë dhe kjo më së miri dëshmohet me ndërtimin e spitalit të qytetit i cili është krenaria e qytetit të Vushtrrisë dhe i cili është spitali më i mirë në Republikën e Kosovës e ndoshta edhe në rajon. Mandej EBA ndihmuan qytetarët tanë në shumë çështje dhe asnjëherë më parë nuk kemi pasur probleme me këto donacione por, nëse organet kompetente dyshojnë në këto donacione, atëherë le t'i argumentojnë ato dhe iniciojnë hetime lidhur me këto tema. Në anën tjetër në të kundërtën e kësaj ka qytetarë që janë për ndërtimin e kësaj xhamie gjë për të cilën ajo ka biseduar me ta. Andaj theksoi se nuk duhet krijuar kësi lloj polemikash dhe konsideron se duhet të lejohet ndërtimi i xhamisë në parcelën që është kërkuar nga KBI. Në këtë relacion konsideron se KBI-dega në Vushtrri dhe qytetarët të gjejnë një marrëveshje për çështjen e kësaj xhamie e cila është objekt fetar dhe e cila duhet të na bashkojë dhe jo të shkaktojë ndarje. Sido që të jetë ajo deklaroi se është pro ndërtimit të xhamisë dhe kërkon se vota e saj "për" të evidentohet në procesverbal. Në fund duke iu referuar vlerësimeve të disa anëtarëve të kuvendit, të cilët thonë: se më mirë është të ndërtohet një shkollë sesa një xhami, kjo është krejt në rregull, por ata anëtarë të kuvendit duhet të marrin guximin dhe kurajën që këto deklarime kundër ndërtimit të xhamisë t'i bëjnë në foltoren e kuvendit.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - vlerësoi se duhet t'i jepet e drejta e ndërtimit të xhamisë Këshillit të Bashkësisë Islame Dega në Vushtrri, dhe shtoi se KBI ka dhënë një kontribut të çmuar në të gjitha etapat e zhvillimit të qytetit tonë. Në fund tha se duhet të falënderohen miqtë tanë që po bëjnë investime në qytetin tonë dhe për këtë vlerësoi se duhet të ndahet një fond për mikpritjen e tyre gjatë qëndrimit të tyre në vendin (qytetin) tonë.

Adnan Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se peticioni i banorëve kundër ndërtimit të xhamisë nuk është në kundërshtim me të drejtat pronësore të banorëve të atij lokaliteti dhe kundërshtimi i tyre nuk bartë me vete ndonjë shqetësim real. Tutje shtoi se kompetent për t'iu përgjigjur nevojave të xhematit dhe organizimit të jetës fetare sipas numrit të banorëve dhe sipas kërkesës së këtyre banorëve që janë praktikues (të fesë), atëherë lidhur me këto çështje vendos Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri, i cili si i tillë është përgjegjës për t'i vlerësuar nevojat e

xhematit në këtë rast. Pastaj ceku se prona ku pretendohet të ndërtohet kjo xhami është e KBI-së dhe për ndërtimin e këtij tempulli fetar janë zhvilluar procedurat ligjore në drejtorinë kompetente, kurse lidhur me dyshimet dhe prapaskenat e ngritura lidhur me këtë projekt duhet të merren organet kompetente. Në fund tha se e përveç që përkrah Këshillin e Bashkësisë Islame për ndërtimin e kësaj xhamie, mbështet edhe peticionin e afro 200 banorëve nga ai lokalitet, të cilët kërkojnë që të ndërtohet xhamia në fjalë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se çdo peticion i cili parashtrohet për shqyrtim në kuvendin nënkupton shprehjen e pakënaqësisë nga ana e qytetarëve. Tutje shtoi se paraqitja e peticionit dhe e kundërpeticionit ka ardhur si rezultat i moskomunikimit me komunitetin lokal parashtrues të këtij peticioni dhe kjo praktikisht e ka sjell kuvendin në një situatë jo të këndshme. Në vazhdim ai apeloj që të gjendet një marrëveshje e pranueshme dhe e arsyeshme për të dyja palët, dhe në këtë kontest njoftoi palët se kuvendi në këtë mbledhje nuk do të merr kurrfarë vendimi për këtë çështje sepse afati ligjor për zgjidhjen e kësaj çështjeje vazhdon edhe më tutje. Pastaj tha se duhet të mendojmë që të bisedojmë me qytetarët që të gjejmë një zgjedhje së bashku, në të kundërtën ne mund t'iu themi se kuvendi nuk është ai që vendos për ndërtimin apo jo të xhamisë. Janë ligjet që e rregullojnë këtë çështje, të cilat duhet t'i zbatojë Drejtoria e Urbanizmit. Pastaj apeloj që para se të vijë te një zgjedhje e pakënaqshme për të dyja palët ose mos të detyrohet organi komunal të veprojë sipas ligjeve, ai bëri thirrje që Bashkësia Islame së bashku me qytetarët që të gjejnë një zgjedhje që do t'i konvenojë të dy palëve.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - shprehu shqetësimin për peticionin në fjalë, duke vlerësuar se me këtë është paraqitur problemi i këtyre qytetarëve për të cilin ata si anëtarë të kuvendit nuk ndihen mirë. Tutje shtoi se për këtë çështje është ngritur edhe një kundërpeticion për të cilin kuvendi nuk ka qenë i njoftuar dhe ky kundërpeticion vetëm sa e rëndon gjendjen akoma më shumë. Pastaj ajo shfaq shpresën e saj se debati në kuvend do ta ndihmojë çështjen në zgjidhjen e këtij problemi dhe propozoi që për këtë çështje të formohet një komision prej tre anëtarëve, i cili do merrej me gjetjen e një zgjidhje të arsyeshme dhe të pranueshme nga të gjithë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se tema për të cilën është duke u diskutuar nuk duhet të shkaktojë ndarje, por duhet t'i unifikojë të gjithë në gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme, pasi që bëhet fjalë për një tempull të një rëndësie të posaçme ku njerëzit e praktikojnë të drejtën e besimit. Pastaj ceku se prona në të cilën pretendohet të ndërtohet kjo xhami është e definuar, por duhet pasur parasysh faktin se në atë pronë a lejohet ndërtimi me planin urban të qytetit, që i bie se me dokumentet komunale duhet të përcaktohet destinimi i asaj prone dhe pronave përreth. Tutje vlerësoi dhe thirri për një debat gjithëpërfshirës duke filluar nga komuna. KBI në Vushtrri, si dhe qytetarët e atij lokaliteti që gjejnë një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi është i obliguar që të shqyrtojë çdo peticion të parashtruar nga qytetarët që i adresohen komunës dhe kuvendit në veçanti. Pastaj ceku se prona e apostrofuat në të cilën pretendohet të ndërtohet xhamia është e Bashkësisë Islame dhe ata kanë të drejtë të ndërtojnë konform rregullave urbane, por edhe qytetarët kanë të drejtë të ankohen për kundërshtimin e ndërtimit të ndonjë objekti të caktuar. Mandej ai njoftoi se Bashkësia Islame iu është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Urbanizmit për pajisje me leje ndërtimore për ndërtimin e xhamisë dhe me sa dihet në atë zonë ndërtimi është i lejuar, por nëse ajo zonë është e ndaluar për ndërtim, atëherë s'ka se përse të diskutohet kjo temë. Në fund tha se kuvendi nuk e ka të drejtën as të ndalojë, por as të japë leje për ndërtim të ndonjë objekti të caktuar dhe në këtë kontekst Drejtorisë së Urbanizmit i propozoi: Që në rastin e vendosjes për dhënie të lejes ndërtimore për ndërtimin e xhamisë në parcelën e sipërcekur të bazohet në suazat ligjore të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Ligjit për Ndërtim, Statutit të Komunës i cili përcakton përgjegjësitë e Drejtorisë së Urbanizmit, Rregullores Komunale për Ndërtim, si dhe në aktet tjera nënligjore.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për”, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që në rastin e vendosjes për dhënie të lejes ndërtimore për ndërtimin e xhamisë në parcelën e sipërcekur të bazohet në suazat ligjore të: Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Ligjit për Ndërtim, Statutit të Komunës i cili përcakton përgjegjësitë e Drejtorisë së Urbanizimit, Rregullores Komunale për Ndërtim, si dhe në aktet tjera nënligjore.

Gjithashtu kuvendi kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm që banorët e kësaj zone, parashtrues të peticionit dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri, të njoftohen me shkrim për shqyrtimin e peticionit nga ana e kuvendit të komunës, si dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e drejtorisë lidhur me çështjen në fjalë.

14. Të ndryshme.

Shqyrtimi i Propozim-vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së - paraqiti sqarime lidhur me vendimin e kuvendit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme, i marrë më datë 30.06.2016, ku ceku se nga ministria e linjës është kërkuar të bëhen disa korrigjime që në titullin e vendimit duhet të shtohet fjala vendimi paraprak, dhe në pikën tre duhet të hiqet fjalia “çmimi fillestar”, si dhe shprehja ankand për faktin se Ligji për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim dhe rregullorja nuk e parasheh një nocion të tillë, prandaj me këto ndryshime i propozoi kuvendit që ta aprovojë këtë propozim-vendim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë në ngastrat kadastrale nr. 2256-11- e cila është pronë e komunës, Zona Kadastrale Vushtrri, me kulturë oborr 500 m², kullosë 110m² dhe ndërtesë 200m², gjegjësisht gjithsej: 810m² ku nga sipërfaqja e përgjithshme jepen në shfrytëzim 675 m², e cila gjendet në rrugën “Jeton Tërrstena” Vushtrri.
2. Prona e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik, për persona fizik dhe juridik, për rregullimin dhe ndërtimin e objektit banesor-afarist, të cilat janë të parapara sipas planeve rregulluese urbane në fuqi.
3. Komuna do ta ruajë interesin e saj publik përmes kushteve që do t’i përcaktojë në rastin e zhvillimit të procedurave të konkursit publik, kurse pjesën tjetër investitori.
4. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje

të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit.

5. Pjesë e këtij Vendimi janë: certifikatat e pronësisë, kopja e planit, incizimi gjeodezik, skica e Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë e paraqitur në pjesë grafike dhe pjesa tekstuale.
6. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi i kuvendit të komunës më 01 nr.127/16 i datës 30.06.2016, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore i Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës (tokë bujqësore dhe kullosa)

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - tha se në pikën dy të këtij propozim-vendimi ku thuhet se: ngastrat kadastrale të cekura në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura lavërtare, çmimi fillestar do të jetë 100 € euro për 1 ha në vit, *propozoi që të bëhet 50 € për 1 ha në vit*, kurse lidhur me rekomandimin e pranuar nga Zyra ligjore ku thuhet se nuk mund të jepet prona në shfrytëzim me mundësi vazhdimi kërkoi që *afati i dhënies së pronës në shfrytëzim të jetë 10 vite*.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP - paraqiti sqarime lidhur me parcelën kadastrale në Zonën Kadastale Gllavatin ku sipërfaqja në bazë të certifikatës së pronës është 10.22.33 ha, kurse në bazë të gjendjes faktike kjo duhet të jetë 7.0.30 ha, për arsye se në këtë pronë ka pasur ndarje fizike ku sipërfaqe prej 0.75.00 ha janë destinuar për vendosjen e varrezave.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, tjerat abstenuan vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës - tokës bujqësore dhe kullosa në këto ngastra kadastrale:

1.1 Ngastra Kadastrale me nr.P-177/1 dhe P-227 me sipërfaqe prej 08.85.97 ha, zona kadastrale Dobërllukë, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.2 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202028-00087-0, me sipërfaqe prej 02.07.50ha, zona kadastrale Stanoc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.3 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00142-0, me sipërfaqe prej 01.02.35ha, zona kadastrale Stanoc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.4 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00754-0, me sipërfaqe prej 01.37.69 ha, zona kadastrale Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.5 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00756-0, me sipërfaqe prej 00.72.05 ha, zona kadastrale Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.6 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202028-00067-0, me sipërfaqe prej 02.03.85 ha, zona kadastrale Stanoc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.7 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202017-00565, me sipërfaqe prej 7.30.00 ha, zona kadastrale Gllavotin, pronë e Komunës së Vushtrrisë;

1.8 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202042-00004-0, me sipërfaqe prej 13.84.83 ha, zona kadastrale Miraçë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastrat kadastrale të cekura në piken 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura lavërtare, çmimi fillestar do të jetë 50 € euro për 1 ha në vit, në afat për 10 vite.

3. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata për të drejtën e pronësisë dhe kopja e planit.
c). Shqyrtimi i njoftimit lidhur me Draft-buxhetin e komunës për vitin 2016.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se lidhur me buxhetin janë mbajtur disa takime buxhetore dhe kryetari i komunës ka kërkuar nga të gjitha subjektet politike që të sjellin propozimet e tyre deri në aprovimin final të buxhetit të komunës për vitin 2017. Gjithashtu ai propozoi që para se të bëhet final buxheti, të specifikohen rrugët që do të asfaltohen në qytet dhe në fshatra, që fillimisht ato të jepen në vija të trasha me qëllim që anëtarët e kuvendit të mund të kenë qasje dhe të japin propozimet e tyre lidhur me këto projekte.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – vlerësoi se qytetarët e Komunës së Vushtrrisë nuk janë më të pasur se qytetarët e komunave tjera të Republikës së Kosovës, të cilat ka marrë vendim që shpenzimet e varrimit të mbulohen nga komunat respektive. Andaj në këtë kontekst kërkoi që në kuadër të buxhetit komunal për vitin 2017 edhe komuna jonë t'i planifikojë këto shpenzime. Pastaj ceku se komuna ka ndarë një parcelë për ndërtimin e një objekti (ndërtese kolektive) për familjet me gjendje të rëndë sociale dhe të pastrehë, andaj në këtë çështje vlerësoi se duhet gjetur një modalitet i cili do mundësojë që përmes ndonjë donatori të përfundohet ky projekt. Mandej ceku se komuna jonë nuk ka fare objekt për strehimin e personave të moshuar dhe edhe në këtë kontekst duhet të gjendet ndonjë mënyrë për ndërtimin e një objekti "shtëpie" dhe kjo do mund të bëhej përmes bashkëfinancimit apo përmes ndonjë donatori.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se nuk është mirë që pika e cila ka të bëjë me buxhetin e komunës të futet si pikë në të ndryshme pasi që kjo pikë është tema më e rëndësishme për kuvendin dhe për komunën në përgjithësi. Tutje shtoi se kjo pikë kaq me rëndësi është dashur që të futet si pikë e rregullt apo ndoshta është dashur të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme ku do të shqyrtohej buxheti komunal. Në kontekst të planifikimit të buxhetit për vitin 2017 propozoi që të planifikohen mjete për ndërtimin e një banese të banimit social që në këtë rast do t'u bëhej zgjidhja e banimit familjeve të cilave komuna iu paguan qiranë e banimit. Ajo ndër të tjera apostrofoi rreth 18 familje që janë me gjendje të rëndë të banimit. Pastaj ndërtimi i një rrugice në rrugën "Jeton Tërrstena" e cila kërkohet për një kohë të gjatë nga qytetarët që të bëhet ndërtimi i saj. Në fund pyeti se a janë planifikuar mjete për pagesën e këshillave të fshatrave dhe ceku se shpreson që në këtë projekt-buxhet të inkorporohen kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke i arsyetuar shqetësimet e parafolësës vlerësoi se nevoja për ndërtimin e një objekti social për familjet me gjendje të rëndë ka qenë e kahotshme, për faktin se gati që nga paslufta komuna ka paguar rreth 24,000.00 € qira për familjet me gjendje të rëndë të banimit. Pastaj shprehu shqetësimin e tij se në mbledhjen e KPF-së planifikimet buxhetore për shëndetësinë kanë qenë në tjerë parametra, kurse tani ato kanë ndryshuar. Tutje ceku se është joserioze që mungojnë drejtorët e drejtorive në mbledhjen e kuvendit dhe shtoi se

nuk është mirë që gjërat të kalohen kështu shpejt e shpejt dhe tani të dalin gjëra të paparashikuara dhe probleme të mëvonshme. Në kontekst të planifikimit të buxhetit njoftoi se vitin e kaluar në shëndetësi kanë qenë të planifikuara mbi 200,000.00 €, dhe propozimi i tij ka qenë që të ulen këto shpenzime dhe tani jemi në muajin e shtatë andaj duhet të shikohet se si janë shpenzuar këto mjete. Pastaj tek subvencionet në kujdesin parësor shëndetësor janë marrë nga 30,000.00 € çdo vit edhe pse kjo nuk ka bazë ligjore për faktin se nëse komuna dëshiron të subvencionojë, atëherë ato mjete duhet t'i merr nga mjetet e saj e jo nga granti specifik i shëndetësisë. Mandej vlerësoi se janë paraparë pak mjete financiare për nevojat për shërim të personave që kanë kërkesa të tilla e që këto mjete janë shumë të domosdoshme, dhe ne akoma nuk e kemi raportin për t'u njoftuar sesa është shpenzuar ky buxhet. Në këtë rrafsh ai kërkoi që nëse do t'i marrim mjetet nga granti specifik i shëndetësisë, atëherë këto mjete duhet të dedikohen ekskluzivisht për barna dhe për mjekimin e personave me nevoja të tilla dhe jo për gjëra tjera (siç është qiraja dhe pagesat tjera), sepse këto pagesa duhet të bëhen nga buxheti i DSHPS-së që është nga administrata dhe jo që këto mjete të merren nga kujdesi parësor shëndetësor. Në vazhdim ai përsëriti që nga mbledhja e fundit e KPF-së ishin paraparë 200,000.00 € për mallra dhe shërbime në lëmin e shëndetësisë, kurse tani po figurojnë mbi 360.000.00 €, dhe për këtë kategori duhet të bëhen llogari se sa kemi shpenzime e jo të planifikojmë mjete pa nevojë. Pastaj në kategorinë e subvencioneve janë paraparë 90,000.00€ që është një shumë e vogël, kurse investime kapitale 88,327.00 € që është gjithashtu shumë e vogël dhe se do të ishte shumë më e arsyeshme dhe më e logjikshme të bëhej një projekt për ndërtimin e një ndërtese të banimit social sesa të ndërtohen rrugë aty ku nuk ka banorë. Në fund kërkoi seriozitet nga të gjitha drejtoritë dhe nga anëtarët e kuvendit në lidhje me planifikimin e buxhetit në kuptimin që “gjërat të cilat vendosen në letër” të mos ndryshohen më vonë.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - kërkoi që në projekt-buxhetin komunal për vitin 2017 të planifikohen mjete financiare për ndërtimin e lapidarit për Sadri Maksutin dhe Skënder Malën, të cilët në vitet e 90-ta kanë dhënë jetën e tyre për atdhe.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se edhe më parë ka kërkuar që të gjitha ndarjet buxhetore në projekt-buxhetin për vitin 2017 t'i dërgohen në mënyrë analitike sipas kodeve ekonomike të propozuara dhe për këtë çështje ka marrë obligim drejtoria gjegjëse. Tutje përsëriti propozimin e tij që shtyhet përpara projektit për subvencionimin e kamatave për zhvillimin e mikrobizneseve në theks të veçantë në lëmin e bujqësisë. Në vazhdim ai vlerësoi se ky projekt ka ngelur vetëm si ide dhe nuk është bërë ndonjë përparim i veçantë në këtë drejtim. Në fund kërkoi nga anëtarët e kuvendit që deri në aprovimin final të buxhetit të komunës të analizohet propozimi i tillë dhe i njëjti të inkorporohet në buxhetin e komunës për vitin 2017.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - propozoi që në lëmin e shëndetësisë të rriten subvencionet për faktin se kemi shumë kërkesa për ndihmë financiare për shërim të personave që vuajnë nga sëmundje të ndryshme, dhe për këtë komuna shpeshherë nuk po ka mundësi që këtyre personave t'u dalë në ndihmë. Pastaj ai kërkoi që të bëhet racionalizimi i orientimit të projekteve kapitale (rrugëve) që ato të ndërtohen në rajonet ku ka banorë dhe jo në vendet “e pabanueshme”, për faktin se në këso formash po bëhen shumë padrejtësi dhe kështu shumë qytetarë po zhvendosen në qytet dhe fshatrat po mbesin të zbrazëta.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.

2.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komunë, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

3. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF), që si hartues i Draft-Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të Komunës Në rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Buxhetit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2016.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione (për ndërtimin e dy shtëpive)

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se i jemi mirënjohës donatorit për këtë vepër humane për grumbullimin e mjeteve financiare për ndërtimin e shtëpive për familjet me gjendje të rëndë sociale dhe të banimit. Tutje shtoi se është mirënjohës për këtë dhe komuna duhet të participojë në këto projekte dhe se përzgjedhja e këtyre dy qytetarëve për t'i ndihmuar nuk duhet të paragjykohet por, theksoi se një qytetar i quajtur Gani Bunjaku gjendet në situatë të rëndë sociale dhe shëndetësore ku fëmijën e ka të sëmurë dhe në këtë rast propozoi që të shtohen mjetet financiare nga komuna që të futet në këtë listë edhe ky qytetar.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHMS-së - tha se dy familjet e përzgjedhura për t'i ndihmuar janë në gjendje të rëndë ekonomike, përkatësisht janë nën asistencë sociale. Në kontekst të ndërtimit të këtyre shtëpive kërkoi nga Drejtoria e Urbanizmit që këto dy familje të lirohen nga shpenzimet për pajisje me leje ndërtimore. Pastaj njoftoi se rasti i Gani Bunjakut i cili është kthyer nga Gjermania dhe më t'u kthyer sërish është futur në sistemin e pagesës së qirasë nga ana e komunës.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit - tha se komuna duhet të angazhohet më tepër në gjetjen e donatorëve që t'iu dalë në ndihmë qytetarëve që janë në gjendje të rëndë sociale dhe të banimit. Tutje shtoi se gjatë vizitës që ka pasur në familjen e Zenë Zejnullahut i ishte gëzuar faktit se atij i ishte bërë shtëpia andaj në këtë kontekst vlerësoi se është mirë që komuna të gjejë forma për ofrimin e donatorëve për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota "për", tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumën prej 4.000 (katër mijë euro) nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, pjesëmarrje në financim të ndërtimit të shtëpisë për banim për:

1.1. Z. Lutfi Hajdari, nga fshati Mihaliq, në shumën prej 2.000 € (dy mijë euro)

1.2. Z. Naser Bilalli, nga fshati Pasomë, në shumën prej 2.000 € (dy mijë euro).

2. Mjetet e ndara me këtë vendim shfrytëzohen si bashkëfinancim me donatorë, të cilët kanë siguruar shumën prej 26.000 € (njëzet e gjashtë mijë euro) për ndërtimin e dy shtëpive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës në pronësi komunale nga "lumë" në rrugë publike

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit - në cilësinë e anëtarit të komisionit për verifikimin e gjendjes faktike lidhur me këtë pronë, njoftoi se në atë lokacion ekziston një problem për faktin se në atë parcelë më herët ka ekzistuar një "prrockë" e cila gjatë ndërtimit është tjetërsuar ku edhe rruga është ngushtuar në ç' rast është krijuar një gjendje e re faktike (ku janë ndërtuar shtëpi dykatëshe), dhe sipas tij tani nuk ia vlen që këto shtëpi të rrenohen, andaj përsëriti se kur merret vendimi nuk duhet të ngutemi që të shkaktojmë dëme nga vendimet tona. Në këtë kontekst ai vlerësoi se tani ndodhemi para "aktit të kryer" për faktin se në atë lokalitet ka filluar shtrimi i rrugës me zhavorr, janë vendosur gypat e kanalizimit dhe tani është krijuar një komision dhe ky komision duhet të veprojë ashtu siç ky investitor e ka menduar këtë projekt. Në fund përsëriti që kuvendi të mos ngutet për të marrë vendim për faktin se aty kemi edhe një problem tjetër sepse ekziston një themel i cili shkakton probleme në hapjen e rrugës.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - tha se komisioni ka qenë i mandatuar që të konstatojë gjendjen faktike në relacion se a ka apo jo në atë pronë "lumë" dhe komisioni ka konstatuar se në atë pronë nuk ka lumë.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë, duke shtuar se komisioni nuk ka për detyrë që të hap rrugë, por vetëm të konstatojë se në parcelën e cekur a ka lumë apo jo dhe konstatoi se nga gjendja në terren nuk ka lumë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se nuk është mirë që në saje të vendimeve tona të krijohen huti apo edhe ndoshta konflikte e që më vonë ne nuk do të mund të qëndronim prapa tyre. Tutje shtoi se cili është qëllimi i këtij komisioni që të konstatojë se komuna a dëshiron të bëjë hapjen e asaj rruge për ata banorë apo vetëm të konstatohet se ajo pronë është komunale dhe të dihet se është e uzurpuar nga ana e atyre banorëve.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - duke iu referuar raportit të komisionit, pyeti se kush e ka bërë shtrimin me zhavorr të asaj rruge, si dhe thuhet se në fund të parcelës rruga është e mbyllur me një mur dhe për këtë pyeti se për çfarë muri bëhet fjalë dhe kush e ka lejuar ndërtimin e këtij muri.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP - paraqiti sqarime lidhur me pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit - tha se duhet kuptuar faktin se në atë parcelë ka ekzistuar një "lumë" (prrockë), por i njëjti është mbyllur për shkak të ndërtimeve të mëdha që janë bërë në këtë lokalitet, dhe ceku se askush nga ata banorë nuk ka kërkuar që të hapet ajo rrugë, porse kjo kërkesë ka ardhur pas ndërtimit të objektit kolektiv banesor nga kompania "Zariqi" dhe kjo po bëhet për t'ia rritur vlerën atyre banesave të kësaj kompanie. Pastaj ai saktësoi se ajo rrugë në fillim është e gjerë, por kah fundi i saj ajo ngushtohet deri në 1 metër dhe e keqja është se tani në atë lokalitet kemi gjendje faktike të krijuar pas ndërtimeve të shumta dhe kjo do të paraqet shumë probleme për të ardhmen për rrenimin e atyre objekteve.

Sabri Ferati, anëtar i kuvendit - tha se në atë lokalitet ka qenë një prrockë e cila është mbyllur, gjegjësisht është futur në kanalizim pas ndërtimeve të bëra në atë pjesë dhe për këtë janë në dijeni organet kompetente. Tutje shtoi se atje tani ka ndryshuar gjendja dhe ai "lumë" nuk ekziston më dhe nëse nuk bëjmë ndërrimin e kulturës së kësaj prone vetëm sa do t'i pengojmë investimet që po bëhen atje. Lidhur me këto gjëra ai vlerësoi se dikush duhet të bartë përgjegjësi dhe ceku se nëse e mohojmë të drejtën e ndërrimit të destinimit të kësaj prone vetëm sa do të shkaktojmë më shumë dëme.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë nuk tregon gjendjen ashtu si është dhe theksoi se thuhet se është ngushtuar rruga për të cilën po bëhet fjalë. Tutje shtoi se Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është dashur zyrtarisht të dalë në terren dhe të konstatojë edhe ta lirojë pronën e uzurpuar në atë rrugë nëse ekziston interesi publik dhe jo të bëhen veprime për interesa dritëshkurtra të individëve të caktuar. Në fund ai theksoi se autoritetet duhet të jenë më serioze në lirimin e pronës komunale dhe jo në këto forma përmes komisioneve kuvendare dhe kuvendit të tentohet të "fshehet" mospuna dhe papërgjegjësia e zyrtarëve kompetent komunal.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se komisioni i cili është formuar ka pasur për kompetencë që të konstatojë se në atë pronë a ka pasur „lumë” apo jo. Tutje shtoi se tani shtrohet pyetja se në atë pronë komunale a ka uzurpime a po jo dhe nëse ka atëherë ajo duhet të lirohet dhe të hapet rruga ashtu si duhet. Mandej nga mbledhja e kaluar e kuvendit është thënë se pritet përgjigjja nga Ministria e Ambientit lidhur me ndërrimin e kulturës së kësaj prone, dhe nëse një kërkesë e tillë është bërë nga Drejtoria e Kadastrit, atëherë duhet të pritet përgjigjja e mistrisë lidhur me atë se a kemi të drejtë apo jo për ndërrimin e kulturës së kësaj prone.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - tha se gjatë këtij debati kanë ndodhur shumë keqkuptime, dhe shtoi se në atë rrugë kur po kërkohet lirimi i pronës, prona është e liruar, por nëse kërkohet të kalohet në rrugën tjetër atëherë duhet të priset muri dhe të lirohet dhe zgjerohet rruga. Në fund tha komisioni e ka kryer punën konform autorizimeve të marra nga kuvendi dhe se ai nuk ka të drejtë t’i jap apo mos t’i jap të drejtë dikujt të ndërtojë apo të lirojë prona nga uzurpimet.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP - paraqiti sqarime përfundimtare lidhur me propozimvendimin në fjalë duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se është i çuditshëm fakti se si po silltet kuvendi në këso lloj situatash të palakmueshme, kur dihet fakti se është dashur që të ndalohen veprimet për futjen e këtij “lumi” në gypa të kanalizimit sepse tani kur është ndryshuar gjendja në terren është e kotë që të formohen komisione sepse lumi është mbyllur në kanalizim, rruga është shtruar me zhavorr dhe tani nuk mund të ketë fare „lumë” në atë lokalitet. Në fund duke iu referuar drejtorit të Drejtorisë së Pronës theksoi se nuk mjafton që të ketë argumente gojore, por duhet të na bind në saje të dokumenteve të shkruara.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - tha se çështja e cila është objekt i shqyrtimeve tona është se në pjesën e parcelës prej 499 m² me gjatësi 150 metra ku fillimi i gjerësisë i kësaj rruge është 4.30 metra dhe përfundon me një gjerësi prej 2.50 metra dhe ne kemi për obligim që këtë pronë ta shndërrojmë në rrugë publike apo të mbetet kultura ashtu siç është në elaboratin kadastral “lumë”.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se tani kuvendi ndodhet në një konfuzion dhe nuk e di sesi të votojë, andaj ceku se drejtori i DGJKP-së nuk i paraqiti sqarimet e nevojshme për ta qartësuar këtë çështje. Tutje theksoi se është dashur të pritet përgjigjja e ministrisë gjegjëse lidhur me ndërrimin e kulturës së kësaj prone. Në këtë kontekst parafranoi drejtorin e DGJKP-së se nuk ka marrë përgjigje nga ministria e linjës për tre muaj rresht kur dihet fakti se afati për të dhënë përgjigje është një muaj.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - pyeti se përse nuk është pritur përgjigjja e ministrisë gjegjëse lidhur me marrjen e pëlqimit për ndërrimin e kulturës së kësaj prone kur dihet fakti se në certifikatën e pronës kjo pronë figuron me kulturë “lumë” dhe në këtë kontekst dyshon se do të reagojë edhe Agjencioni për Mbrojtjen e Lumenjve me arsyen se në elaboratin kadastral kjo pronë figuron si lumë. Në fund tha se gjerësia e kësaj rruge prej vetëm 1 metër nuk do të mund të jetë funksionale dhe e njëjta nuk do të mund as të ndërtohet andaj lidhur me këtë gjendje kërkoi interpretimin e Zyrës ligjore.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - kërkoi nga Zyra ligjore e komunës, që të jap interpretim se a ka drejt kuvendi të marrë një vendim të tillë për ndryshimin e kulturës së kësaj prone, apo paraprakisht për këtë çështje duhet të merret pëlqimi i ministrisë gjegjëse.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor - tha se Zyra ligjore përmes adresimit nga drejtoria kompetente e ka trajtuar këtë çështje dhe ka rekomanduar që drejtoria duhet të konsultohet me Departamentin për Menaxhimin e Ujërave në kuadër të MMPH-së. Tutje shtoi se Udhëzimi Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokave, njëra nga dispozitat e tij e rregullon çështjen e ndërrimit të kulturës së tokave pyjore, por nuk flet për ndërrimin e destinimit të pyjeve. Në fund tha se duhet të pritet përgjigjja (pëlqimi) nga ministria gjegjëse lidhur me ndërrimin e kulturës së kësaj prone.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se pasi është bërë ndryshimi i gjendjes faktike në këtë pronë atëherë nuk duhet t'i shkaktohen pengesa investitorit i cili dëshiron të investojë në këtë pronë.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së - tha se çështja e cila ka ardhur deri këtu është bërë për faktin se kërkesa e investitorit Ahmet Zariqi për ndërtimin e një objekti banesor, në momentin kur është shqyrtuar është konstatuar se në certifikatën e pronës prona me kulturë është “lumë”. Andaj menjëherë është njoftuar investitori dhe lënda është proceduar në organin kompetent në Drejtorinë e Kadastrit dhe më vonë në kuvend. Në fund vlerësoi se asgjë kontestuese në këtë çështje nuk ekziston dhe kërkoi nga kuvendi që ky vendim të aprovohet.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se pas aprovimit të këtij vendimi i njëjti do të shkojë për vlerësim në MAPL dhe MMPH dhe nëse kemi diçka që nuk është në pajtim me ligjin atëherë ky vendim do të mund të shfuqizohet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 11 vota “për”, 7 vota “kundër” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendimi lejohet ndërrimi i destinimit për parcelën P-70202016-02119-0, në sipërfaqe prej 499 m², ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë nga shfrytëzimi aktual “lumë” e njëjta destinohet në rrugë publike.

2.Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

dh).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve për nder të 1 shtatorit “Ditës së Dëshmorëve”.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – paraqiti sqarime lidhur me këtë propozim-vendim, duke prezantuar specifikacionin e shpenzimeve për këtë projekt, i cili ka të bëjë me organizimin e aktiviteteve për nder të 1 shtatorit “Ditës së Dëshmorëve”, projekt i cili ka një kosto financiare prej 2.500 €

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se përpos drejtorit të financave është dashur që të jetë prezent edhe drejtoresha e DKRS-së për të dhënë sqarime se këto mjete a kanë qenë të parapara në kuadër të planit buxhetor të Drejtorisë së Kulturës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve i ndahen mjete financiare në vlerë prej dy mijë e pesëqind euro (2.500 €), për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

2.Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria transfere dhe subvencione dhe do të shërbejnë për organizimin e aktiviteteve për nder të 1 shtatorit „Ditës së Dëshmorëve” të UÇK-së.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e kryetarit të komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

e). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit

Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit - kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të bëhet ndërrimi i gypave të ujit të pijshëm në rr.“Hamdi Gashi” dhe lidhja duhet të bëhet nga

rr. "Skënderbeu" afër shkollës fillore "Mustafë Venhari" deri tek rr. "Hamdi Gashi" në afërsi të banesave të bardha.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit - pasi shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me "lëvizjet" e shumta brenda sallës në mbledhje të anëtarëve të kuvendit dhe mungesën në mbledhje të drejtorëve të drejtorive, pyeti se çfarë është duke ndodhur me tregun e bagëtive i cili është i mbyllur për afro tre muaj radhazi dhe për këtë pyeti se cila është arsyeja e mbylljes së këtij tregu. Gjithashtu ai pyeti për gjendjen e klubit të futbollit "Vushtrria".

Mbledhja përfundoi në orën 15:55.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit

